



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 203

30 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 177/2013 datë 28.12.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar	9031
Ligj nr. 178/2013 datë 28.12.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar	9033
Ligj nr. 179/2013 datë 28.12.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	9036
Ligj nr. 180/2013 datë 28.12.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	9039
Ligj nr. 181/2013 datë 28.12.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar	9050
Ligj nr. 182/2013 datë 28.12.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.....	9056
Ligj nr. 183/2013 datë 28.12.2013	Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, datë 12.4.1994, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)”	9057
Ligj nr. 184/2013 datë 28.12.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	9058

LIGJ
Nr. 177/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 8, shkronja “gj” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 8/1, në fjalinë e parë, fjala “vetjakë” zëvendësohet me fjalën “personalë”.

Neni 3

Në nenin 8/1, “Të ardhura të përjashtuara”, fjalia e parë e pikës 11 ndryshohet si më poshtë:

“Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer apo person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale.”.

Neni 4

Pasqyra nr. 1, e përmendur në pikën 1 të nenit 9, “Tarifat tatimore”, që i bashkëlidhet ligjit, zëvendësohet me pasqyrën me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Nenet 12, 12/1, 12/2, 12/3, 12/4, 12/5 dhe 12/6 shfuqizohen.

Neni 6

Neni 13/4 “Shkalla tatimore” shfuqizohet.”

Neni 7

Në nenin 16, “Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin”, dhe kudo në përmbajtje fjalët “i tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël” zëvendësohen me fjalët “i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël”.

Neni 8

Në nenin 25, “Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit”, fjalët “por, në çdo rast, pa tejkalar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim” shfuqizohen.



Neni 9

Neni 28, “Shkalla tatimore”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Shkalla tatimore

Tatimi mbi fitimin është 15 për qind.”.

Neni 10

Neni 35 “Mbajtja e tatimit dhe regjistrimi” riformulohet si më poshtë:

“Neni 35

Mbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa

a) Paguesi i shumave është i detyruar të mbajë regjistrime për llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për çdo përfitues të ardhurash dhe t’i vërë ato në dispozicion të organeve tatimore dhe të personit përfitues të të ardhurave, për të cilin është bërë pagesa.

b) Paguesi i shumave, për efekt të mbajtjes së tatimit në burim, të parashikuar në nenin 33, “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit”, është i detyruar të llogarisë, të mbajë, të deklarojë dhe të derdhë tatimin e mbajtur në burim, në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës.

c) Ministri i Financave përcakton me udhëzim formën dhe përmbajtjen e deklaratës.

ç) Deklarata e tatimit të mbajtur në burim dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në drejtorinë rajonale ku është i regjistruar paguesi i shumave.”.

Neni 11

Në nenin 38 “Dispozitat kalimtare”, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Vetëm për periudhën tatimore të vitit 2013, subjektet e biznesit të vogël të tatimit mbi të ardhurat personale plotësojnë dhe dorëzojnë Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël, sipas shkronjës “gj” të nenit 8 dhe neneve nga 12 deri në nenin 12/6 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, brenda datës 10 shkurt 2014.”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2014.

Miratur në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8444, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

Tabela nr. 1 Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		Përqindje
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	30 000	zero për qind
30 001	130 000	+ 13 për qind të shumës mbi 30 000 lekë
130 001	Më tepër	13 000 lekë + 23 për qind të shumës mbi 130 000 lekë

LIGJ

Nr. 178/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9975,
DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, “Përkufizime”, pika 3, fjalët “Buxhetit të Shtetit” zëvendësohen me fjalët “drejtorive rajonale tatimore, për t’u transferuar më pas në Buxhetin e Shtetit”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 8 hiqet fjala “njëpërdorimësh”.
2. Pas pikës 8 shtohet pika 8.1 me këtë përmbajtje:

“8.1. “Ambalazh” është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë. Ai e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, “Nivelet e taksave kombëtare”, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:
“Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 17 lekë/litër për benzinën dhe 17 lekë/litër për gazoilin.”
2. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:
“8. a) Taksa e ambalazheve plastike caktohet në masën 100 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Vetëm për industrinë vendase të riciklimit, taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend caktohet në masën 50 lekë/kg.



Këto ambalazhe e kanë përmbajtjen prej lëndë të parë plastike, sipas klasifikimit të dhënë në kapitullin 39 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në fuqi. Kjo taksë zbatohet për të gjithë artikujt prej plastike të kreut 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në rastet kur importohen veçmas, si dhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Kjo taksë mblihet nga administrata doganore në momentin e importit, në rastet kur importohen.

Kjo taksë mblihet nga administrata tatimore në rastet kur produktet me ambalazh plastik prodhohen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të para, granulateve dhe artikujve gjysmë të gatshëm që përdoren në prodhim.

Taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend caktohet në masën 50 lekë/kg, me kusht që subjekti ta provojë këtë fakt me anë të kartës teknologjike të prodhimit, deklaratave të importimit të lëndëve të para, si dhe dokumentimit të blerjeve të lëndëve të para brenda vendit. Kjo taksë mblihet nga administrata tatimore në rastet kur produktet paktohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh plastik, të prodhuar nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të prodhuara nga riciklimi për qëllime përdorimi të ambalazheve.

b) Taksa e ambalazheve të qelqit caktohet në masën 10 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Kjo taksë zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi të përmendur në kreun 7010 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në rastet kur importohen veçmas, si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Kjo taksë mblihet nga administrata doganore në momentin e importimit, në rastet kur importohen. Kjo taksë mblihet nga administrata tatimore në rastet kur artikujt paktohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh prej qelqi, të prodhuar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit. Mënyra e monitorimit të lëndëve të para, që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave.”.

Neni 4

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1, “Deklarata për pagesën e rentës minerare” me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të pikës 4 të nenit 4 të këtij ligji, detyrohen:
 - a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit në të cilin janë realizuar shitjet;
 - b) të paguajnë taksën e rentës minerare për atë muaj në ose para datës së detyrueshme të deklaratës.
2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, bëhet në formën dhe përmbajtjen siç përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.
3. Deklarata për pagesën e rentës minerare dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për procedurat tatimore”, pranë drejtorisë rajonale tatimore, ku është i regjistruar personi fizik/personi juridik zotërues i lejes minerare apo eksportuesi në rastin e eksportit me të tretët.”.

Neni 5

Neni 6, “Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në drejtorisë rajonale tatimore dhe në llogaritë e njërive të qeverisjes vendore”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Agjentët e taksave, me përjashtim të rasteve kur me dispozita të veçanta të këtij ligji është parashikuar ndryshe, rakordojnë me drejtoritë rajonale tatimore për shumat e arkëtuara nga taksat kombëtare, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, brenda datës së fundit të çdo muaji, si dhe transferojnë menjëherë për llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në llogari të bashkive ose të komunave shumat e mbledhura, për t’u transferuar më pas në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 6

Në nenin 8, “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, dhe transferohen në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore dhe të llogarive të njërive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.”.

2. Paragrafi i parë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Agjentët e taksave, për shërbimin që kryejnë, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të taksave që kanë transferuar në llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore.”.

Neni 7

Në nenin 9, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Përjashtohen nga pagimi i taksës së ambalazheve të plastikës dhe të qelqit, sipas përcaktimeve të nenit 4:

a) importimi për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve diplomatike dhe konsullore, përfshirë edhe konsujt e nderit, si dhe misionet speciale të akredituara në Shqipëri;

b) importimi për nevoja zyrtare dhe personale të organizmave ndërkombëtarë, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë e sipas limiteve dhe kushteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë formuar këta organizma ose në marrëveshjet reciproke;

c) importimi i produkteve për qëllime të ndihmave humanitare;

ç) ambalazhet plastike të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si më poshtë:

i) arkat plastike;

ii) fuçitë me kapacitet ≥ 20 litra;

iii) kapakët e CD-ve dhe DVD-ve;

iv) kutitë paketuese dhe tasat për ushqime;

v) kutitë e votimit;

vi) mbajtëset për kafe, çaj, erëza;

vii) mbajtëset për ushqimet, si: marmelatë, bukë, salcë, fruta, gjalpë, vaj etj.;

viii) paketuesit për serumet, gjakun dhe barnat mjekësore;

d) ambalazhe qelqi, të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si më poshtë:

i) ampulat për barnat mjekësore;

ii) shishet për mbajtjen e serumit, gjakut dhe barnave mjekësore;

dh) ambalazhet plastike dhe qelqi, të vendosura nën regjime doganore pezulluese.”.



Neni 8

Në nenin 11, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

Miraturar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8445, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

LIGJ

Nr. 179/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, “Fusha e veprimit”, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Neni 15, “Zyrat tatimore të qeverisjes vendore”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Zyrat tatimore të qeverisjes vendore funksionojnë dhe zbatojnë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” dhe administrojnë taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore, me përfshirje të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vlerëson, mbledh, kontrollon dhe arkëton tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.”.

Neni 3

Në nenin 29, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon sistemin qendror të të dhënave për secilin tatimpagues.”.

Neni 4

Në nenin 45, paragrafi i dytë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“Organi tatimor kompetent, brenda 30 ditëve nga data e këtij njoftimi, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve deri në çastin e aplikimit për çregjistrim në QKR (në rastin e personave fizikë) ose deri në çastin e aplikimit për fillimin e procedurave të likuidimit në QKR ose në gjykatë (në rastin e personave juridikë) dhe, kur është e nevojshme, të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti, sipas një analize risku.”.

Neni 5

Në nenin 59, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150 000 lekë.”.

Neni 6

Në nenin 69, në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur nuk mund të provohet e saktë data e marrjes së vlerësimit të detyrimit tatimor, konsiderohet të jetë marrë 10 ditë nga data e nisjes me postë.”.

Neni 7

Në nenin 70, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për detyrimet tatimore, të lidhura me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatimor nxirret nga drejtoria rajonale tatimore.”.

Neni 8

Në nenin 71, shkronja “e”, shuma “300 000 lekë” zëvendësohet me shumën 150 000 lekë”.

Neni 9

Në nenin 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, fjalët “brenda 30 ditëve kalendarike” zëvendësohen me fjalët “brenda 60 ditëve kalendarike”.

Neni 10

Në nenin 83, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Tatimpaguesi ka të drejtë t’i kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 ditëve kalendarike pas datës kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.”.

Neni 11

Në nenin 90, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Me përjashtim të rasteve kur në ligj është parashikuar ndryshe, nëse në bankën, ku tatimpaguesi ka llogarinë bankare, ka edhe urdhra të tjerë pagese, urdhri i lëshuar nga administrata tatimore ekzekutohet sipas radhës së përcaktuar në nenin 605 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Neni 12

Në nenin 107, pikat 1, 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare



për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.”.

Neni 13

Në nenin 109, “Vendimi i drejtorisë”, në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Drejtoria e Apelit merr masat për publikimin, në *website*-in e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të qëndrimeve të mbajtura në vendimet e marra prej saj.”.

Neni 14

Në nenin 110, “Rimbursimi i detyrimit tatimor, pagesa e kamatëvonesës dhe e gjobës”, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Nëse tatimpaguesi ka paraqitur garanci për pagesën e detyrimit, kjo çlirohet tërësisht apo pjesërisht sipas vendimit të drejtorisë së apelit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi.”.

Neni 15

Neni 113, “Mosdeklarimi në afat”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 113

Mosdeklarimi në afat

Tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon deklaratën tatimore në afat, dënohet me gjobë me 10 000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar.”.

Neni 16

Në nenin 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, pika 3 shfuqizohet.

Neni 17

Neni 117, “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 117

Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave

Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifave të mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhur apo të shmangur.”.

Neni 18

Në nenin 120, “Pagesa ose arkëtimet me para në dorë mbi 300 000 lekë”, në titull dhe në përmbajtje shuma “300 000 lekë” zëvendësohet me shumën “150 000 lekë”.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2014.

Miraturar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8446, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

LIGJ

Nr. 180/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 61/2012,
“PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 10, pika 3, shkronja “dh” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 67, pikat 1 dhe 2, fjalët “forcë alkoolike” zëvendësohen me fjalët “shkallë alkoolometrike”.

Neni 3

Neni 68 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 68

Përcaktime të tjera

Akciza e birrës përcaktohet në bazë të hektolitrave për shkallë alkoolometrike të produktit përfundimtar.”.

Neni 4

Titulli i kreut IX ndryshohet si më poshtë:
“KREU IX KAFEJA DHE PIJET ENERGJIKE”.

Neni 5

Në nenin 76, “Përkufizime”, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) Pijet energjike janë pije që klasifikohen në Kodin e Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave 2202 10 00 dhe që kanë në përmbajtje të tyre sasi kafeine të barabartë ose më shumë se 0,03% të volumit ose përbërësit taurinë, guaranë ose ginsenk.”.

Neni 6

Në nenin 77, Detyrimet”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:



- “Akciza për pijet energjike paguhet duke pasur si njësi matëse 1 litër”.
2. Në pikën 3, pas fjalës “kafesë” shtohen fjalët “pijeve energjike”.

Neni 7

Pas nenit 88 shtohet neni 88/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 88/1

Prodhimi klandestin i duhanit dhe nënprodukteve të tij

1. Kushdo që prodhon në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine) duhan dhe nënprodukte të tij, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me:

a) gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto mallra të akcizës, të prodhuara në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine), por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë. Gjoha, përveçse për produktet tërësisht të përfunduara, zbatohet edhe për produktet që mund të përftoheshin nga lëndët e para në përpunim ose në pritje për t'u përpunuar apo që gjenden në mjediset, në fabrikë a në lokalet ku është kryer shkelja;

b) përveç masës së gjobës, të parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike, dënohet edhe me sekuestrim të makinerive, pajisjeve, mjeteve ndihmëse të prodhimit, lëndës së parë, çdo material të nevojshëm për prodhimin e këtyre produkteve, si dhe të të gjitha mallrave të akcizës të gjetura në çdo kohë.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, me “prodhim të paautorizuar” kuptohet prodhimi që kryhet në mjedise dhe me pajisje të padeklaruar e të pakontrolluara paraprakisht ose të ndërtuara apo të modifikuara në atë mënyrë që produkti të shmanget nga verifikimi. Pjesët e pajisjes që shërbejnë si provë për fabrikimin e paautorizuar të nënprodukteve të duhanit janë makineritë e grirjes, pajisjet e fermentimit, të aromatizimit, të paketimit etj.

3. Prodhimi i paautorizuar provohet edhe vetëm me praninë në të njëjtin mjedis ose në mjediset ngjitur të lëndëve të para të nevojshme për përgatitjen e produkteve të akcizës, si dhe të pajisjeve a pjesëve të tyre të nevojshme për përgatitjen, para se fabrika dhe pajisjet të jenë deklaruar te autoritetet doganore dhe të jenë verifikuar prej tyre për përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji.

4. Në rast se në çastin e konstatimit gjenden vetëm pajisje ose pjesë të tyre të padeklaruar dhe të paverifikuara, pa praninë e lëndëve të para, shkelësi dënohet me gjobë në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë.

5. Përdorimi i paautorizuar i makinerive të grirjes së duhanit, qoftë dhe për përdorim vetjak, dënohet me gjobë në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë.

6. Kushdo që ndërton, shet ose jep për përdorim një pajisje përpunimi të duhanit për qëllime tregtie, pa e deklaruar paraprakisht, dënohet me gjobë në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë.

7. Pas aplikimit të dënimit, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, autoritetet doganore procedojnë me konfiskimin e tyre, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.

8. Mallrat e konfiskuara shkatërrohen ose administrohen sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 8

Pas nenit 89 shtohen nenet 89/1 dhe 89/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 89/1

Shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për duhanin dhe nënproduktet e tij

1. Pavarësisht nga ndjekja penale për këtë qëllim, shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për duhanin dhe nënproduktet e tij dënohet:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës, por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës, por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës, por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë, kushdo që:

i) shmang me çfarëdo mënyre duhanin dhe nënproduktet e tij nga verifikimi ose pagimi i akcizës;

ii) mban duhan dhe nënprodukte të tij në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara nga autoritetet doganore ose i përdor ato për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat i është dhënë përjashtimi.

2. Shkelja e mbetur në tentativë ndëshkohet si shkelje e kryer.

3. Përdoruesit të përjashtuar, kur është kryer shkelja e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, i hiqet për dy vjet e drejta për të përfitur nga përjashtimet.

4. Kur duhani dhe nënproduktet e tij mbahen në kushte të ndryshme nga ato të paracaktuara nga autoritetet doganore, konsiderohet si shkelje dhe zbatohet gjobë sa 5-fishi i detyrimit fiskal që duhej paguar.

Neni 89/2

Shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për kafen dhe pijet energjike

1. Pavarësisht nga ndjekja penale për këtë qëllim, shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për kafen dhe pijet energjike dënohet si më poshtë:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar;

ç) konfiskim të mallit të gjetur.

2. Mallrat e konfiskuara shkatërrohen ose administrohen, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 9

Në nenin 91, pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Për efekt të përlllogaritjes së masës së detyrimeve të akcizës për mangësitë apo tepricat në magazinat e prodhim/stokimit të naftës bruto, niveli i akcizës do të llogaritet në masën 25 lekë/kg.”.

Neni 10

Pas nenit 91 shtohet neni 91/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 91/1

Teprica ose mangësi në mjediset e pritësve të regjistruar

1. Mangësitë mbi 2 për qind, përveç firove të lejuara, të konstatuara gjatë kontrollit në mjediset e pritësve të regjistruar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Nëse gjatë kontrollit konstatohen sasi tepër, krahasuar me regjistrin e hyrje-daljeve, dhe nëse sasia tepër nuk kalon 2 për qind të sasisë së raportuar, pritësi i regjistruar gjobitet me 100 000 (njëqind mijë) lekë.



3. Për teprica në mjediset e pritësit të regjistruar mbi 2 për qind dhe të pajustificuara në dokumentacionin përkatës zbatohet, për herën e parë të konstatuar, gjobë sa 2-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, por, për çdo rast, jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë; për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, por, për çdo rast, jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe për herën e tretë të konstatuar e më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, por, për çdo rast, jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë. Përjashtim bën rasti kur tregohet prejardhja e ligjshme e produktit dhe shlyerja e rregullt e detyrimit. Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël.”.

Neni 11

Në nenin 96 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për shkeljet e parashikuara nga ky nen në transportimin e naftës bruto, për efekt të penalizimit, niveli i akcizës për këtë produkt do të llogaritet 25 lekë/kg.”.

Neni 12

Pas nenit 96 shtohet neni 96/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 96/1

1. Shkeljet, të cilave u referohet shkronja “a” e pikës 1 të nenit 85, të paparashikuara shprehimisht në këtë kre dhe të cilat:

a) nuk kanë sjellë mospagim të detyrimeve fiskale që duheshin paguar, pavarësisht nga ndjekja penale për këtë qëllim, dënohen me gjobë që shkon nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

b) kanë sjellë mospagim të detyrimeve fiskale që duheshin paguar, pavarësisht nga ndjekja penale për këtë qëllim, dënohen:

i) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për produktet e akcizës, por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë;

ii) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për produktet e akcizës, por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë;

iii) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për produktet e akcizës, por, për çdo rast, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë.”.

Neni 13

Shtojca 1, që i bashkëlidhet ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

Përjashtimisht, neni 1 hyn në fuqi në datën 1 prill 2014.

Miratuar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8447, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

SHTOJCA Nr. 1: MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla taksimit
	I	KAFE DHE PIJE ENERGJIKE	
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e Pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura , lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg kafe
D000	22 02 10 00	Pije energjike	50 lekë/litër
	II	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
B000 Birra	22 03	Birrë e bërë nga malto: -nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të vogël se 200 000 HL në vit: Nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të madhe se 200 000 HL në vit	360 lekë/HL/shkallë alkoologjike 710 lekë/HL/shkallë alkoologjike
W200 Vera e qetë dhe pjet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10 22 06 00 51 22 06 00 59 22 06 00 81 22 06 00 89	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara. - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	3 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 4 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 10 000 lekë/HL për verërat me forcë alkooolike deri në 12,5 gradë dhe 12 000 lekë/HL për verërat me forcë alkooolike mbi 12,5



W300 Vera spunante, Shampanja dhe pijet e fermentuara dhe të gazuara	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08 22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 31 22 06 00 39	Verërat spumante, Shampanja; Verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa “kërpudhë” që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dioksidit të karbonit. Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak. Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara.	5 200 lekë/HL
I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme	22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 31 22 06 00 39 22 06 00 51 22 06 00 59 22 06 00 81 22 06 00 89	Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum por që nuk e kalon 22% volum; Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.	5 200 lekë/HL

S200 Pije alkoolike (Spirituos Beverages).	22042192	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërsive të rrushit, Whisky, Rum dhe të tjera pije të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva, Vodka, likere dhe tonike, Uzo.		
	22042193			
	22042194			
	22042195			
	22042196			
	22042197			
	22042198			
	22042992			
	22042993			
	22042994			
	22042995		- nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 20 000 hektolitër/vit	65 000 lekë për HL alkool anhidër
	22042996			
	22042997		- nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 20 000 hektolitër/vit	84 500 leke për HL alkool anhidër
	22042998			
	22051090			
	22059090			
	22060010			
	22060031			
	22060039			
	22060051			
	22060059			
	22060081			
	22060089			
	22082012			
	22082014			
	22082026			
	22082027			
	22082029			
	22082040			
	22082062			
	22082064			
	22082086			
	22082087			
	22082089			
	22083011			
	22083019			
	22083030			
	22083041			
	22083049			
	22083061			
22083069				
22083071				
22083079				
22083082				
22083088				
22084011				
22084031				
22084039				
22084051				
22084091				



	22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010 22087090 22089011 22089019 22089033 22089038 22089041 22089045 22089048 22089052 22089054 22089056 22089069 22089071 22089075 22089077 22089078		
S300 Alkooli etilik jo i denaturuar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	45 000 lekë për HL alkool anhidër
S400 Alkool etilik i denaturuar	22072000	Alkool etilik i denaturuar	0 (zero)
S400 Rakia sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082029	Raki	20 000 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2 % ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	45 000 lekë për HL alkool anhidër
	III	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 500 lekë/kg
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	4 500 lekë/1000 copë më 1 janar 2014 5 000 lekë/1000 copë në 1 janar 2015

			5 500 lekë/1000 copë më 1 janar 2016 6 000 lekë/1000 copë më 1 janar 2017
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	3 000 lekë/kg më 1 janar 2014 3 700 lekë/kg më 1 janar 2015 4 400 lekë/kg më 1 janar 2016 5 100 lekë/kg më 1 janar 2017
	IV	PRODUKTET ENERGJITIKE	
E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krerët 1507 deri 1518 të NK nëse përdoren për ngrohje apo motorë	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që i përkasin kodeve NK të kreut 2707	50 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë/litri
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	50 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguret Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 20 lekë/litri



E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
E450	2710 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
E460	2710 20	Biodiesel me vajra nafte	37 lekë/kg
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
E471	27109100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso	40 lekë/kg
E480	2713 11 00 2713 12 00	Koks nafte	2 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
E491	27 14 90 00	Të tjera (bitum dhe asfalt natyral; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg bitum
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpininën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (p.sh. asfalto-beton)	5 lekë/kg bitum
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400 27111900	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	0 lekë/litri
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	37 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	37 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (Alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg

L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore/ Biodiezel me më pak se 70% vajra naftë të kapitullit 27	37 lekë/litri
	V	FISHEKZJARRËT	
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
	VI	GOMAT	
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg
P300 Goma të përdorura	40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
	VII	PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË	
A100 Pilat dhe bateritë primare	85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
A200 Akumulatorët	85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshi ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshi katrorët)	20 lekë/kg
	VIII	LLAMBA INKANDESHENTE	
Y100 Llambat inkadeshente	85 39 22 10 85 39 22 90 85 39 29 92 85 39 29 98	Llambat reflektor Të tjera Më tepër se 100 V Jo më tepër se 100 V	100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa



LIGJ
Nr. 181/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, “PËR
SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, 113, pika 1, shkronja “ç”, 155 e 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 9, “Llojet e taksave”, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.”.

Neni 2

Kreu III, “Taksa vendore e biznesit të vogël”, me nenet 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19, ndryshohet si më poshtë:

“KREU III

“TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL”

Neni 10

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Neni 11

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, është 7,5 për qind dhe, për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 2 milionë lekë, është 25 000 lekë në vit.

Neni 12

Shpenzimet e njohura

Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuar nga ky ligj.

Neni 13

Shpenzimet e panjohura

1. Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet e mëposhtme:

- a) kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës e të truallit;
- b) kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të veprimtarisë, të cilat amortizohen, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;
- c) vlera e shpërblimeve në natyrë;
- ç) interesat e paguar, të cilët tejkalojnë normën mesatare të interesit 12-mujor të kredisë, për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë;
- d) gjobat, kamatëvonesat dhe kushtet e tjera penale;
- dh) krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera speciale, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore;
- e) tatimi mbi të ardhurat personale dhe ato nga biznesi;
- ë) shpenzimet për përfaqësim dhe për pritje-përcjellje, të cilat e tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;
- f) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave;
- g) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar për qëllime tatimore në ligjin nr. 7892, datë 21.11.1994, “Për sponsorizimet”, nuk njihen si shpenzime të njohura shumat e sponsorizuara që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit;
- gj) shpenzimet për dhurata;
- h) çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi;
- i) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, të faturuara nga persona të tretë, për të cilat nuk është paguar tatimi në burim, brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi”.
- j) humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, transitimit dhe magazinimit tej normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;
- k) shpenzimet për pagat, shpërblime dhe çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të cilat lidhen me të ardhurat nga marrëdhëniet me punësimin, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë dhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- l) shumat e paguara në *cash*, mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ll) nëse gjatë periudhës tatimore huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkalar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm;
- m) borxhi i keq, nëse nuk plotësohen tri kushtet e përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.
- Një borxh i keq, që është mbledhur, duhet të përfshihet si e ardhur në çastin e mbledhjes;
- n) shpenzimet për udhëtime, ushqim, akomodim dhe lëvizje duhet të kufizohen te shumat e specifikuar me udhëzim të Ministrit të Financave;
- nj) shpenzimet për asetet kapitale, përveç shpenzimeve për tokën, veprat e artit dhe pasuri të tjera që nuk amortizohen, në pronësi të tatimpaguesit dhe të përdorura për veprimtaritë e biznesit të tatimpaguesit, do të mbulohen gjatë kohës përmes shpenzimeve të amortizimit, sipas përcaktimeve të mëposhtme:
 - i) kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e të pajisjeve, me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, në mënyrë lineare, me 5 për qind;
 - ii) amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind;



iii) kompjuterët, sistemet e informacionit, produktet *software* dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave amortizohen në bazë të vlerës së grupit, me 25 për qind;

iv) të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind.

2. Baza e amortizimit është vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore, duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivitetit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë, gjatë periudhës tatimore dhe, duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera të pavullnetshme, gjatë periudhës tatimore. Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet së ardhurës së tatueshme dhe baza e amortizimit merret zero. Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit është një shpenzim i zbritshëm i veprimtarisë. Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë, nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

Neni 14

Mbajtja e regjistrimeve

Librat dhe regjistrimet, që kërkohet të mbahen nga tatimpaguesit, janë: libri i shitjes (i qarkullimit), libri i blerjeve, libri i shpenzimeve dhe i të ardhurave dhe libri i aktiveve të biznesit, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 15

Parapagimi

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, për subjektet me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, llogaritet në bazë të formularit të deklarimit tatimor të biznesit të vogël, i cili përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

Të gjithë tatimpaguesit me qarkullim nga zero deri në 2 milionë lekë në vit paguajnë si tatim të thjeshtuar mbi fitimin një tatim fiks, në masën 25 000 lekë në vit te drejtoritë rajonale tatimore. Kjo pagesë kryhet brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti.

Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

2. Tatimpaguesi parapaguan tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të ndarë në katër këste vjetore, në bazë të fitimit të tatueshëm, sipas deklarimit të parashikuar në nenin 16 të këtij ligji.

3. Në rast se aktiviteti i biznesit hapet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit.

4. Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti. Me kryerjen e pagesës dhe marrjen e konfirmimit bankar të kryerjes së pagesës, tatimpaguesi shkon te zyrat e shërbimit tatimpagues tatimor dhe, kundrejt paraqitjes së dokumentit bankar të pagesës, merr "Pullën e tatimit" të kështit, për të cilin ka bërë pagesën. Dizenjot dhe elementet e pullës caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Tatimpaguesi e vendos pullën e tatimit lart certifikatës së regjistrimit në QKR për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dhe shpenzimet përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. "Pulla e tatimit" duhet të përmbajë elemente të sigurisë së lartë për të shmangur falsifikimin e tyre. Tatimpaguesit me qarkullim nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit paguajnë tatimin fiks, në masën 25 000 lekë në vit, te drejtoritë rajonale tatimore brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, te bankat e nivelit të dytë, për llogari të drejtorisë rajonale tatimore. Për kryerjen e pagesës dhe marrjen e konfirmimit bankar të kryerjes së pagesës,

tatimpaguesit shkojnë te zyra e shërbimit tatimpagues tatimor dhe, kundrejt paraqitjes së dokumentit bankar të pagesës, marrin “Pullën e tatimit”, për të cilën kanë bërë pagesën.

5. Drejtoritë rajonale tatimore bëjnë regjistrimin e arkëtimit tremujor të tatimit, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së tatimit me zyrat e tatimeve të bashkive dhe komunave. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 16 **Deklarimi**

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, është i detyruar që, deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga Ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Deklarata dorëzohet në bankat, me të cilat administrata tatimore ka marrëveshje për pranimin e deklaratave dhe të pagesave dhe ajo shoqërohet me çdo kërkesë për rimbursim apo me çdo shumë për t'u paguar.

Neni 17 **Administrimi i tatimit**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë dhe komunat. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

Neni 18 **Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agjentit tatimor**

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore. Komisioni kalon në llogari të Buxhetit të Shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të “Pullave të tatimit”.

Neni 19 **Bashkëpunimi**

1. Drejtoria rajonale tatimore njofton bashkinë ose komunën jo më pak se një herë në gjashtë muaj për punën e bërë për nivelin e vjeljes së këtij tatimi.

2. Bashkia dhe komuna, kur e gjykojnë të nevojshme, i kërkojnë organit tatimor kryerjen e veprimeve për plotësimin e detyrave për administrimin e tatimit dhe derdhjen në favor të saj, sipas afatit ligjor të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël.”.

Neni 3

Në nenin 20, “Përcaktimi dhe llojet”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:



“3. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive dhe komunave të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë.”.

Neni 4

Aneksi 1, i përmendur në pikën 2 të nenit 21, “Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme”, që i bashkëlidhet ligjit, zëvendësohet me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Në nenin 22, “Taksa mbi ndërtesat”, në fund të pikës 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.”.

Neni 6

Në nenin 33, “Taksat e përkohshme”, fjalja e dytë shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 35, “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, pika 2, fjalët “por, në asnjë rast, shumica e tarifave vendore të aplikueshme për tatimpaguesit e biznesit të vogël nuk duhet të kalojë 10 për qind të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël” shfuqizohen.

Neni 8

Në nenin 36, “Fillimi i ushtrimit të kompetencave”, shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Për vitin 2014, tatimpaguesi parapaguan tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të ndarë në katër këste vjetore, në bazë të fitimit të tatueshëm për vitin 2013, sipas deklaramentit të të ardhurave personale të biznesit të vogël, të bërë në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

4. Brenda datës 30 janar 2014, njësitë e qeverisjes vendore u përcjellin drejtorive rajonale tatimore të gjitha të dhënat për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 në 8 milionë lekë.”.

Neni 9

Ngarkohet Ministri i Financave që, në datën 1 janar 2014, të nxjerrë udhëzimin për zbatimin e ligjit.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

Miraturar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8448, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

Aneksi 1: Nivelet treguese të taksës së ndërtesës

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m² në vit			
I. Ndërtesa banimi			
- ndërtuar para 1993	15	10	5
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993	30	12	6
II. Ndërtesa të tjera			
- Për tregti dhe shërbime	400	300	200
- Të tjera	100	60	40
III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	400	400	400

Shënim I: Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për ndërtesat në zonat urbane (bashkitë), si dhe për ndërtesat në të gjitha zonat (urbane dhe rurale) të seksionit III të tabelës “Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike”.

Shënim II: Në zonat rurale (komunat), niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës (përjashtuar seksionin III) është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në bashkitë qendër rrethi, në të cilat ndodhet komuna.

Shënim III: Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuar për shtije, por që janë ende të pashitura, taksë do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambientet e hipotekuara si:

- apartamente banimi do t’i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa banimi”;
- ndërtesë biznesi do t’i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime”.



LIGJ
Nr. 182/2013

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995, “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 19, “Furnizime të përjashtuara”, pika 1, pas numrit “25.10” shtohet numri “25.11”.

Neni 2

Në nenin 25/1, “Operacionet hidrokarbure”, fjalët “lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure” zëvendësohen me fjalët “lidhur me realizimin e fazës së kërkimit”.

Pas shkronjës “a” shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjetikën përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e mallrave dhe shërbimeve të lidhura me fazën e kërkimit, si dhe procedurën e përjashtimit.”.

Neni 3

Pas nenit 25/10 shtohet neni 25/11 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/11

Barnat dhe shërbimi shëndetësor

Nga data 1 prill 2014, furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i përjashtuar. Ministri i Financave përcakton me udhëzim, para datës 1.4.2014, mënyrën se si veprohet lidhur me sasinë e barnave që rezultojnë gjendje në datën 1.4.2014.”.

Neni 4

Në nenin 26/1, “Furnizimet e përjashtuara në import”, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “ç” fjalët “lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure” zëvendësohen me fjalët “që lidhen me realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure”.

2. Në fund të paragrafit të parë të shkronjës “ç” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjetikën përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e mallrave dhe shërbimeve të lidhura me fazën e kërkimit, si dhe procedurën e përjashtimit.”.

3. Në shkronjën “i”, fjalët “subjektet e tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël” zëvendësohen me fjalët “tatimpaguesi subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.

Neni 5

Nga data 1 prill 2014, në nenin 30, “Shkalla tatimore”, pika 2 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 50, “Rimbursimet”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjalia e parë e pikës 3 riformulohet si më poshtë:

“Për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi vlerën e shtuar, i paguar, u rimbursohet financuesve të huaj nga sistemi i thesarit, brenda 30 ditëve, sipas rregullave të caktuara nga Ministri i Financave.”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Duke filluar nga data 1 janar 2014, brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës së tatimpaguesit, drejtoria rajonale e tatimeve kontrollon dhe miraton tepricën kreditore të tatimpaguesit si të rimbursueshme. Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet nga sistemi i thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë të Financave.”.

Neni 7

Në nenin 58, “Biznesi i vogël etj.”, në titull dhe në përmbajtje, fjalët “biznesi i vogël” zëvendësohen me fjalët “tatimpaguesi subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014. Përgjashtimisht, nenet 3 dhe 5 hyjnë në fuqi në datën 1 prill 2014.

Miraturar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8449, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

LIGJ

Nr. 183/2013

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7811, DATË 12.4.1994, “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 782, DATË 22.2.1994, “PËR SISTEMIN FISKAL NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KËRKIM-PROD HIM)”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr. 7811, datë 12.4.1994, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)””, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Neni 4 i dekretit shfuqizohet.”.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2014.

Miraturar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8450, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

LIGJ

Nr. 184/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 383, DATË 24.2.2011, “PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 7, “Baza për llogaritjen e kontributit”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

1. Baza për llogaritjen e kontributit është paga bruto e personit të siguruar.
2. Kontributi i shtetit për personat ekonomikisht joaktivë bazohet në konsumin për frymë të shërbimit shëndetësor, indeksuar me koeficientin e inflacionit. Konsumi për frymë për shërbimin shëndetësor përcaktohet nga Fondi dhe miratohet nga Kuvendi, së bashku me miratimin e buxhetit vjetor.
3. Baza për llogaritjen e kontributit për punonjësit e vetëpunësuar është dyfishi i pagës minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve. Paga minimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve për të vetëpunësuarit në qytet dhe në fshat, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Për sigurimet shëndetësore vullnetare baza e llogaritjes së kontributit është dyfishi i pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve.”.

Neni 2

Në nenin 12, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Fondi i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor nuk financon shërbime të kujdesit shëndetësor ndaj personave që nuk janë të siguruar, me përjashtim të rasteve të urgjencës mjekësore, si dhe të paketës së kontrolleve periodike parandaluese në popullatë, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Neni 16, “Këshilli administrativ”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

1. Këshilli administrativ është organi më i lartë vendimmarrës i Fondit dhe ka në përbërjen e tij 7 anëtarë si më poshtë:

- a) Ministrin e Shëndetësisë ose përfaqësuesin e tij;
- b) Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e tij;
- c) Ministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ose përfaqësuesin e tij;
- ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Fondit ose përfaqësuesin e tij;
- d) Drejtorin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore ose përfaqësuesin e tij;
- dh) Një përfaqësues të sindikatës së të punësuarve;
- e) Një përfaqësues të organizatës së profesionistëve të shëndetësisë.

2. Koha e shërbimit të anëtarëve të këshillit administrativ është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje, ose për atë kohë sa anëtari është përfaqësues i organit përkatës.

3. Këshilli i Ministrave përcakton se cila sindikatë dhe organizatë e profesionistëve të shëndetësisë do të emërojë përfaqësuesin e saj në këshillin administrativ.”.

Neni 4

Neni 17, “Drejtimi i këshillit administrativ”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

1. Këshilli administrativ zgjedh, me votim të fshehtë, kryetarin ndërmjet përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli administrativ zgjedh zëvendëskryetarin ndërmjet përfaqësuesve të kontribuesve joqeveritarë.

3. Kryetari ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, drejton këshillin administrativ.”.

Neni 5

Neni 19, “Drejtori i Përgjithshëm”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

1. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga këshilli administrativ ndërmjet jo më pak se tri kandidaturave të paraqitura nga anëtarët e këtij këshilli, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në statutin e Fondit.

2. Këshilli zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm, me votim të fshehtë, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

3. Koha e ushtrimit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm është 5 vjet.

4. Paga e Drejtorit të Përgjithshëm caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Drejtori i Përgjithshëm raporton para këshillit administrativ.

6. Këshilli administrativ vendos për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm në këto raste:

- a) nëse dënohet me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
- b) nëse shkel dispozitat e statutit, vendimet e këshillit administrativ dhe legjislacionin në fuqi.”.

Neni 6

Në nenin 20, “Funkcionet e këshillit administrativ”, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) miraton statutin, rregullat ekonomike, financiare, procedurale, të auditimit e të kontrollit, si dhe rregulla të tjera të brendshme, që ai i gjykon të nevojshme gjatë veprimtarisë së Fondit, në zbatim të këtij ligji.”.



2. Shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:
“g) miraton numrin e përgjithshëm të punonjësve të Fondit.”.

Neni 7

Në nenin 21, “Funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm”, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të nenit 21 ndryshohen si më poshtë:

“a) propozon për miratim në këshillin administrativ statutin, rregulloret ekonomike financiare, procedurale, të auditimit e të kontrollit, raportin vjetor dhe projektbuxhetin vjetor.

c) propozon në këshillin administrativ numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe miraton strukturën e brendshme, përshkrimet e punës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të zyrave vendore, si dhe rregulloret e organizimit e të funksionimit të përgjithshëm të Fondit.”.

Neni 8

Neni 42/1 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 43, fjalia e fundit shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

Miratuar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8451, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 36 lekë